



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRAN	
01 Nr. / Br	145 / 16
Nr. i fq. / Br. si	- 15
Data: / Datum	28.07.2016
VUSHTRRI - VUČITRAN	



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E VI-të E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË,
MBAJTUR MË 30 QERSHOR 2016

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:10.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:

Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habibe Gërzhaliu Habib Mustafa, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Mungoi: Hysni Gërguri.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –pasi hapi punimet e mbledhje se kuvendit, paraqiti disa pika shtesë të rendit të ditës në piken në të ndryshme pasi siç tha ai disa pika janë plotësuar me rekomandimet e dhëna nga Komitetit për Politikë dhe Financa sikur është fjala për Propozim-vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për 99 vite, kurse propozim-vendimi për hartimin e hartës zonale i cili ka kaluar në KPF por i njëjti është proceduar me vonës për shkak të plotësimeve që kanë qenë të nevojshme të bëhen nga ana e drejtorisë gjegjëse. Pastaj propozoi që draft-plani për integritet i Komunës së Vushtrrisë të futet në rend të ditës si dhe kërkesa e auto-kombajnerëve propozoi që të futet në rend të ditës për të cilin kuvendi duhet ta marr një qëndrim. Në fund tha se është kërkesë e kryetarit të komunës që pika e tretë në renditje Draft-Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Vushtrrisë të hiqet nga rendi i ditës.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota unanime aprovoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Draft-Kornizës Afatmesme (KAB) për vitet 2017-2019;
3. Shqyrtimi i Draft-Planit për Integritet i Komunës së Vushtrrisë për periudhën 2016-2019 (Shqyrtimi i Dytë);
4. Shqyrtimi i informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës;
5. Shqyrtimi i informatës lidhur me inspektimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë;
6. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.192/15 dt. 29.09.2015;
7. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës për Trajtimin e Fëmijëve me Nevoja të Posaçme në fshatin Nedakoc;
8. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit dhe pronësisë së pronave të paluajtshme komunale;
9. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për lejimin e ndërrimit të destinimit të pronës së paluajtshme komunale në pronësi të Komunës;
10. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale ndërtimore të Komunës së Vushtrrisë;
11. Të ndryshme.
 - a). Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë;
 - b). Shqyrtimi i kërkesës së auto- kombajnerëve të Komunës së Vushtrrisë;
 - c). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës Kuvendi me vota unanime aprovoi procesverbalin e mbledhjes paraprake të KK-së.

2. Shqyrtimi i Draft-Kornizës Afatmesme (KAB) për vitet 2017-2019;

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-duke ju referuar kornizës afatmesme buxhetore për vitet 2017-2019 konkretisht tabelës së shpenzimeve komunale të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe ceku se në pozicionin Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për vitin 2017 subvencione dhe transfere për këtë kategori janë paraparë 390,000.00 €, për vitin 2018 janë paraparë 420,000.00 € kurse për vitin 2019 gjithashtu janë propozuar të ndahen 420,000.00 €. Lidhur me këtë çështje ai vlerësoi se forma e deritashme e subvencionimit të bujqësisë nuk ka qenë shumë produktive dhe kjo nuk do të thotë që nuk ka pasur fare efekte por se ky proces është përcjell me mjaft telashe. Andaj lidhur me këtë çështje ai propozoi që mjetet e planifikuara për periudhën tri vjeçare të ndahen dhe të zotohen në emër të subvencionimit të normave të interesit me qëllim të stimulimit të ekonomisë së vogël saktësisht sektorit të bujqësisë. Tutej shtoi se implementimi i këtij projekti të subvencionimit do të duhej të zbatohet përmes procedurave të prokurimit zgjedhjes së subjektit bankar e cila ofron kushte më fleksibile për përfituesit. Pastaj propozoi që për subvencionet të hartohen projekte tre vjeçare dhe të zotohen të ndahen 1,200.000.00 € për periudhën tri vjeçare për subvencionim të normave të interesit (kamatës). Në këtë kontekst ai vlerësoi se nëse realizohet me sukses ky projekt do të kemi gjenerim të vendeve të reja të punës gjegjësisht vetëpunësim prej së paku 1.500 vendeve për faktin se në këtë formë të gjithë fermerët do të kenë qasje në kredi pa kamatë dhe do të investojnë aty ku mendojnë se është më fitimprurëse. Në fund tha se ky propozim duhet të

merret me mjaft seriozitet nga ana e qeverisë komunale për faktin se kemi të bëjmë me gjenerimin e vendeve të reja të punës dhe përfitime për komunën.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit –tha se kur flasim për kornizën afatmese buxhetore duhet të kemi një qasje gjithëpërfshirëse duke trajtuar në detaje këtë dokument zhvillimor komunale dhe duke bërë krahasimet e nevojshme. Tutej shtoi se nëse e krahasojmë këtë dokument me vitet e kaluara atëherë del se kemi shpërputhje të dhënave si për numrin e banorëve për numrin e nxënësve dhe statistika të tjera të cilat do të mund të kalkuloohen dhe kërkoi që këto statistika në këta tregues të kalkuloohen saktë dhe të parashtrihen drejt. Pastaj ai vlerësoi se në këtë dokument është dashur të inkorporohet edhe e dhëna për borxhet e tatimit në pronë gjë e cila është kërkuar edhe nga ana e auditorit të përgjithshëm. Mandej ai duke bërë komperacion me vitet e kaluara ceku se deri sa në vitin 2013 borxhet e tatimit në pronë kanë dhe taksave komunale kanë qenë afro 2,500.000.00 € tani ato nuk figurojnë se si do të jetë plani i inkasimit të këtyre borxheve me qëllim të rritjes së të hyrave komunale për financimin e projekteve të ndryshme. Lidhur me çështjen e inkasimit të tatimit në pronë përsërit qëndrimin e tij se orientimi i projekteve kapitale duhet të bëhet në ato mese ku shkalla e inkasimit të tatimit është më e lartë. Lidhur me arkëtimin e tatimit në pronë ceku se duhet të kemi angazhim maksimal të gjithanshëm për ngritjen e shkallës së inkasimit. Pastaj duke ju referuar projekteve kapitale (shtrimi i rrugëve me asfalt, kanalizim ujësjellës) ceku se në kornizë janë përcaktuar vendbanimet se ku do realizohen këto projekte por për këtë kërkoi specifikim të secilit projekte që do të realizohet dhe mos të ndodh si në të kaluarën që të bëhet ndërrimi i shumave financiare dhe i projekteve apo që kjo çështje të mbetet në vullnetin e një individi që të ndërrohet destinimi i projekteve. Në fund tha se komuna duhet të ketë një planë për inkasimin e tatimit në pronë dhe rritjen e të hyrave komunale si dhe të informohet kuvendi për këtë proces për borxhet sidomos ato të cilat krijohen me dhënien e pronës komunale me qira.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit- duke ju referuar kornizës afatmese buxhetore për vitet 2017-2019 paraqiti disa vërejtje ku në faqen 21 tek planifikimi urban dhe mjedisi ku janë paraparë shumat financiare për realizimin e projekteve duhet të bëhet specifikimi i fshatrave dhe lokaliteteve tjera se ku do realizohen këtë projekte për vitet në vijim. Mandej shtoi se kur hartohet korniza buxhetore dhe bëhen ndarjet buxhetore duhet të ftohen edhe subjektet tjera politike me qëllim të ndarjes së këtyre projekteve në mënyrë sa më të drejt dhe të pranueshme për të gjithë. Pastaj propozoi që në këtë kornizë të përfshihen edhe heqja e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë. Në fund kërkoi që kuvendi të informohet për çështjen e inkasimit e të hyrave komunale nga të dhëna e pronës komunale në shfrytëzim.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-paraqiti sqarime profesionale lidhur me kornizën afatmese buxhetore për vitet 2017-2019 duke u përgjigjur në pyetje e anëtarëve të kuvendit.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se me këtë kornizë po bëhen hapat e parë në planifikimin dhe aprovimin e buxhetit komunal për vitin 2017 ku në mbledhjen e shtatorit që do të mbaj kuvendi do të aprovohet përfundimisht buxheti i komunës. Tutej shtoi se për këtë buxhet dhe për projektet e parapara janë mbajtur disa dëgjime buxhetore dhe se specifikimi i projekteve do të bëhet në fazat e mëvonshme. Pastaj njoftoi se me datën 19 korrik do të mbahet takimi i Komitetit për Politikë dhe Financa ku ky takimi po bëhet tashmë si një praktik e mirë i cili po mbështetet nga OSBE ku do të jete një mundësi e mirë për dhënë e propozimeve për buxhetin e komunës për vitin 2017. Mandej ai vlerësoi se subjektet politike të përfaqësuara në kuvend në këtë takim do të njoftohen me mënyrën e shpërndarjes së buxhetit por njëkohësisht do të dëgjohen e propozimet e tyre lidhur me shpërndarjen e projekteve. Lidhur me subvencionet për bujqësi por edhe në degë tjera ekonomik vlerësoi se këto degë ekonomike do të stimulohen përmes subvencioneve të ndryshme të siç është industria e drurit dhe degë të tjera të cilat do ti japin një impuls ekonomisë në komunën tonë. Lidhur me çështjen e shpërndarjes së subvencioneve propozoi që Drejtoria e Bujqësisë të mbaj një takim të veçantë për ndarjen e këtyre subvencioneve, ku do të ftohshin agrobizneset bizneset tjera mandej anëtarët e kuvendit dhe nga ky takim do përpilohej një listë për ndarjen e këtyre subvencioneve e që në fund do të

votohej në kuvend. Në vazhdim ai njoftoi kuvendi se me qarkoren buxhetore komuna jonë është ngarkuar me të hyra vetanake në raport me komunat tjera të Kosovës në vlerën prej 36 % në raport me vitin e kaluar dhe për këtë është bërë një reagim me anë të një shkrese adresuar Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në fund tha se komuna do të mobilizohet për mbledhjen e borxheve të pa arketueshme sidomos ato nga tatimi në pronë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 24 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Aprovohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2017-2019 e Komunës së Vushtrrisë, konform Qarkores Buxhetore 2017/01 të lëshuar nga Ministria e Financave me të cilin caktohen kufijtë buxhetor të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2017-2019.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

3. Shqyrtimi i Draft-Planit për Integritet i Komunës së Vushtrrisë për periudhën 2016-2019 (Shqyrtimi i Dytë);

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se është bërë një ndryshim i titullit të këtij dokumenti nga Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit dhe tani ka marrë emërtimin Plani për Integritet i Komunës së Vushtrrisë për periudhën 2016-2019 dhe kjo është bërë nga organizata GIZ, për faktin se hartimi i këtij dokumenti është kusht për fitimin e disa projekteve nga ana e kësaj organizate.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit, me 31 vota “për”, tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet Plani për Integritet i Komunës së Vushtrrisë për periudhën 2016-2019.

2. Për zbatimin e këtij plani kujdesen: kryetari i komunës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Vushtrrisë

3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti me emërtimin “Plani për Integritet i Komunës së Vushtrrisë 2016 - 2019”, (i cili ka gjithsej 14 faqeve, prej të cilave 5 faqe përfshijn pjesa tekstuale kurse 9 faqe ka pjesa tabelore).

4. Shqyrtimi i informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës;

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se në bazë të kësaj informate shihet se shumica e vendimeve të kuvendit janë zbatuar ose janë në zbatim, mirëpo ceku se disa vendime të këtij kuvendi nuk janë zbatuar siç është shembull i vije Vendimi për caktimin e lokacionit të varrezave të fshatit Stroc i datës 27.03.2014, pastaj me datën 30.07.2015 është marrë vendimi për formimin e komisionit për verifikimin e gjendjes faktike të varrezave në fshatin Stroc dhe në muajin shtator të vitit 2015 është marrë vendimi për ndryshimin e vendimit Nr.01.70/14 dhe akoma ky vendim nuk është realizuar. Mandej vendimi për kompensimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve i aprovuar me datën 30.11.2015 dhe i njëjti nuk është zbatuar dhe nuk është në procedurë të zbatimit. Pastaj me datën 26.03.2015 kuvendi ka marrë vendim për hapjen e trasesë së rrugëve për vitin 2015 dhe ky vendim nuk është zbatuar në plotëni për arsye se kanë qenë pesë rrugë të cilat është dashur të trajtohen ku disa prej tyre

janë trajtuar ndërsa kanë mbetur pa u trajtuar rruga në fshatin Stanoc i Poshtëm dhe rruga në fshatin Beçuk.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se lidhur me zbatimin e vendimit për caktimin e lokacionit të varrezave në fshatin Stroc është në dijeni për telashet që janë shfaqur dhe për këtë pas krijimit të komisionit kjo çështje është zgjedhur dhe ky vendim do të zbatohet. Kurse për vendimin për kompensimin e anëtarëve të komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve tha se ky komision e ka kryer punën e tij dhe duhet të kompensohet. Ndërsa lidhur me vendimin për hapjen e trasesë së rrugëve ky vendim është në procedurë të zbatimit.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit –tha se të gjitha vendimet e kuvendit e kanë peshën dhe rendësin e tyre andaj të gjitha duhet të zbatohen në përpikëri. Tutje shtoi se e gjithë administrata komunale duhet të mobilizohet në zbatimin ligjeve, rregulloreve dhe vendimeve të kuvendit, me qëllim që vihet rend dhe rregull në të gjitha sferat e jetës. Pastaj lidhur me të hyrat buxhetore ceku se ato vinë kryesisht nga granti i përgjithshëm dhe të hyrat vetanake por dihet se grantet nga niveli qendror po zvogëlohen dhe tani burim i përhershëm i të hyrave do të jetë tatimi në pronë dhe me 65 % të realizimit të tatimit në pronë nuk mund të realizohen projektet kapitale të komunës. Andaj duhet të kemi mobilizim për rritjen e inksimit të të hyrave komunale dhe zbatim të gjitha vendime të kuvendit të komunës.

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-paraqiti sqarime lidhur me realizimin e vendimeve të kuvendit që lidhen me çështjet e pronës komunale duke u përgjigjur në pyetje e anëtarëve të kuvendit.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se lidhur me zbatimin e vendimeve për caktimin e zonave ekonomike të cilat ishin caktuar në fshatrat Bajskë, Sllatin dhe Pasomë prona të cilat iu janë dhënë burgut dhe këto prona janë komunale ku rruga që do të ndërtohet e anashkalon qytetin e Vushtrrisë në drejtim të Mitrovicës dhe për bri të “kodrës” ku ka hapësirë prona të cilat iu janë dhënë burgut është ideja që në këto hapësira të ndërtohet një zonë ekonomike. Kurse lidhur me zonën ekonomike në fshatin Lummadh kjo është parashikuar edhe me planin e zhvillimit ekonomik të mëhershëm dhe për këtë ishte hartuar projekti por Ministria e Bujqësisë e kishte penguar këtë projekt dhe tani ideja është që në atë vend të bëhet një park për agrobizneset. Lidhur me ndërtimin e palestrës sportive ceku se ky projekt është zhvilluar nga niveli qendror dhe komuna ka lidhur një marrëveshje dhe për kundër telasheve që kanë dal ky projekt do të realizohet. Në fund u zotua se do ti intensifikon përpjekjet për inkasimin e borxheve publike të tatimit në pronë dhe apeloj tek të gjithë qytetaret e komunës që ti kryejë obligimet tatimore për faktin se nga data 1 shtator do të filloj faza e ekzekutimit të borxheve përmes përmbaruesit privat.

5.Shqyrtimi i informatës lidhur me inspektimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë;

6.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.192/15 dt. 29.09.2015;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendimi shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë 01 Nr.192/15 i datës 29.09.2015 për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

7. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës për Trajtimin e Fëmijëve me Nevoja të Posaçme në fshatin Nedakoc;

Abdullah Klinaku, drejtor i DSHMS-së- paraqiti sqarime hyrëse lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke arsyetuar edhe propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Qendrës për Trajtimin e Fëmijëve me Nevoja të Posaçme në fshatin Nedakoc.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se edhe në Komiteti për Politikë dhe Financa e kishte përkrahur pa rezervë propozim-vendimin në fjalë por se i kishte paraqitur vërejtjet e tij lidhur me caktimin e lokacionit për ndërtimin e kësaj qendre për faktin se ai lokacion i propozuar nga drejtorja nuk është i qëlluar. Pastaj shtoi se në KPF i kishte propozuar edhe dy lokacione të mundshme për ndërtimin e kësaj qendre dhe nëse nuk gjenden mundësi tjera të shkohet me procedurat e shpronësimit të ndonjë prone për ndërtimin e kësaj qendre. Në fund tha se në vendin ku është propozuar ndërtimi i kësaj qendre ndodhet oborri i shkollës dhe në këtë mënyrë vetëm sa po ngulfatet ky lokalitet dhe për këtë vota e tij do të jetë kundër.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit –tha se komuna ka për obligim trajtimin e barabartë të gjithë qytetarëve të komunës e në këtë kontekst kemi për obligim që të kemi trajtim adekuat të personave me nevoja të veçanta dhe për këtë duhet të gjenden forma dhe mënyra të përshtatshme. Mandej ai kërkoi sqarime për mënyrën e fitimit të donacionit se a është bërë përmes institucioneve komunale apo përmes strukturave të Këshillit të Bashkësisë Islame andej pyeti se kush do të jetë bartës i këtij projekti a do të jetë komuna si institucion dhe nëse po atëherë mjetet e donacionit duhet të derdhen në buxhetin e komunës dhe komuna e merr përgjegjësinë e plotë për këtë projekt.

Tasim Gubetini, anëtar i kuvendit –tha se në KPF është votuar kjo pikë me qëllim që fëmijët me nevoja të veçanta të kenë një trajtim adekuat, mirëpo në anën tjetër është kërkuar që të jenë edhe dy lokacione si alternativë duke marrë për bazë që ai lokacion nuk i plotëson kushtet për ndërtimin e një qendre të tillë për faktin se është oborr i shkollës i njëjti ndodhet buzë rrugës maxhistrale dhe aty pranë ndodhet një fabrikë e betonit dhe në aspektin e ambientit nuk i plotëson kushte që të ndërtohet kjo qendër. Andaj për këto arsye vota e tij do të jetë kundër.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit –tha se donacioni për ndërtimin e kësaj qendre është mjaft i rëndësishëm edhe për kundër faktit se në ende nuk e dimë numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta. Pastaj ai shtoi se ndërtimi i kësaj qendre në lokacionin e propozuar nuk paraqet ndonjë pengesë dhe fakti që kjo qendër po ndërtohet në oborrin e shkollës do të ndikojë në socializimin e këtyre fëmijëve me nevoja të veçanta.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit-propozoi që lokacioni për ndërtimin e kësaj qendre të vendoset tek Qendra e Mjekësisë Familjare ku ishte më herët ish Stacioni i Autobusëve. Tutej në arsyetimin e propozimit të tij ai ceku se kjo qendër duhet të ndërtohet sa më afër qytetit me qëllim të shmangies së shpenzimeve nga familjet që kanë fëmijë me nevoja të veçanta.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit –tha se fëmijët me nevoja të veçanta duhet të kenë një trajtim dinjetoz. Tutje ai tha se duhet të shikohen shumë alternativa për caktimin e lokacionit për ndërtimin e kësaj qendre dhe propozoi që njëra nga alternativat e mundshme do të ishte në oborrin e shkollës “Mustafë Venhari”. Tutej shtoi se menaxhimi i kësaj qendre duhet të bëhet nga Drejtorja e Shëndetësisë dhe Drejtorja e Arsimit që brenda këtyre drejtorive të gjendet mundësia dhe kadri i nevojshëm për menaxhimin e kësaj qendre.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit-tha se kemi mungesë të mbikëqyrjes dhe trajtimit të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe shtoi se është mirë që pas shumë bashkëpunimeve me Komunën e Växjö të Suedisë po bëhet finalizimi i ndërtimit të një qendër të tillë. Pastaj vlerësoi se lokacioni i ndërtimit është i përshtatshëm dhe ceku se duhet të kemi organizim të transportit për fëmijët me nevoja të veçanta pavarësisht faktit se në çfarë lokacioni ndërtohet kjo qendër.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit-tha se të gjithë jemi për realizimin e këtij projekti dhe ceku se kontestuese është vetëm lokacioni se ku do të ndërtohet kjo qendër dhe propozoi që si lokacion i përshtatshëm do të ishte parcela tek “stadiumi i gomës” tek Qendra për Punës Sociale.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 24 vota “për”, tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e Qendrës për Trajtimin e Fëmijëve me Nevoja të Posaçme në fshatin Nedakoc në ngastrën kadastrale nr.110-1, në sipërfaqe prej 0.11.09 ha, Zona Kadastrale Nedakoc, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

8.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit dhe pronësisë së pronave të paluajtshme komunale;

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-paraqiti sqarime hyrëse lidhur me këtë pikë të rendit duke elaboruar çështjen e pronësisë së këtyre aseteve të komunës. Tutje ai paraqiti të dhënë lidhur me sipërfaqet e këtyre pronave dhe mënyrën e dhënies së këtyre pronave Shtëpisë Ndëshkuese Përmirësuese nga ana e komunës. Në fund ai propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të mos votohet por të formohet një komision për verifikimin e gjendje faktike të këtyre pronave.

Idriz Muzaqi, udhëheqës i zyrës ligjore-tha se ky propozim-vendim iu është nënshtruar vlerësimeve të zyrës ligjore dhe se nga këto vlerësime del në pah fakti se pengës për bartjen e të drejtës për këto prona është mungesa e pëlqimit nga autoriteti të cilit iu janë dhënë në shfrytëzim këto prona që këto prona të kthehen në pronës të komunës. Pastaj ceku se në kohën kur këto prona janë dhënë në shfrytëzim janë dhënë pa asnjë kusht dhe për afat të pacaktuar. Andaj lidhur me këtë çështje ai propozoi që të merret pëlqimi nga Ministria e Drejtësisë e cila ka cilësinë e peronit juridik.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit –tha se që në vitin 2002 Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë kishte marr një vendim që disa prona shoqërore por edhe prona tjera ti kthej në pronësi komunale dhe për këtë komuna kishte pasur problem me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe tash po shihet se ai vendim ka qenë i drejt. Lidhur me këtë çështje ai vlerësoi se këto prona por edhe prona të tjera duhet ti kthehen komunës që komuna të ketë mundësi të zhvillimit ekonomik.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit-tha se e përkrah këtë propozim-vendimi që këto prona ti kthehen komunës por kjo duhet të bëhet në mënyrën më të rregullt të mundshme duke marrë pëlqimin nga ministria gjegjëse dhe kthimi i pronësisë të bëhet në mënyrë të plotë legale.

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-tha se Drejtoria e Kadastrit posedon dokumentacionin origjinal me të cilin i është bartë e drejta e shfrytëzimit mbi këto prona Shtëpisë Ndëshkuese Përmirësuese dhe komuna ka të drejtën e pronësisë por tani po kërkohet kthim i të drejtës së shfrytëzimit mbi këto prona.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se është logjike dhe njëherësh e ligjshme që çdo kryetar i komunës të përkujdestë për ruajtjen e buxhetit dhe të pronës komunale andaj me këtë vendim po pretendohet të futet nënë menaxhimin komunal të pronës e cila gjendet në territorin e komunës sonë. Pastaj vlerësoi se shumësia e subjekteve që janë titullar të pronave ka bërë që të kemi mjaft shumë defekte në menaxhimin e pronës komunale. Tutje njoftoi kuvendin që si kryetar i komunës ka bërë kërkesë me shkrim në Ministrin e Drejtësisë për kthimin e këtyre pronave nënë menaxhimin e komunës por kjo ministri nuk ka dhënë pëlqimin për kthimin e këtyre pronave në pronësi komunale. Pastaj ceku se gjatë bisedave që ka zhvilluar me ministrin e drejtësisë e ka njoftuar atë se kuvendi do ta kthejë të drejtën e shfrytëzimit të këtyre pronave pavarësisht nëse ministra do ta japë pëlqimin për këtë çështje dhe për këtë ai (ministri) është pajtuar. Në fund tha se ideja për formimin e një komisioni për konstatimin e gjendje faktike në këto prona është e mirë dhe do ta ndihmonte këtë proces.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit- ishte i mendimit që të formohet një komision mikst nga qeveria komunale dhe kuvendi i cili do të ketë për detyrë që të konstatoj gjendjen faktike dhe do të vërtetonte autorësinë e dokumentacionit nga kopja në origjinal dhe në fund të këtij procesi komisioni do të hartonte një procesverbal të cilin do t'ia adresonte kuvendit dhe kështu në këtë formë në mbledhjen e ardhshme kuvendin do mund të votonte këtë çështje për kthimin e pronësisë në këto prona të komunës dhe ndërprerjen e të drejtës së shfrytëzimit të këtyre nga ana e Qendrës Ndëshkuese Përmirësuese.

Në fund të diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim formohet komisioni komunal për konstatimin e gjendjes faktike lidhur me shfrytëzimin e pronave nga ana e Shtëpisë Ndëshkuese Përmirësuese në fshatin Smrekonicë në këtë përbërje:

- 1.1 Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit (PDK);
- 1.2 Fatime Haziri, anëtare e kuvendit (LDK);
- 1.3 Ali Januzi, anëtar i kuvendit (VV);
- 1.4 Bedri Dobra, (Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër, dhe Pronë) dhe
- 1.5.Ilijana Azemi, (zyrtare në Drejtorin e Urbanizmit).

2.Komisioni në fjalë ka për obligim që të konstatoj gjendjen faktike të pronave që shfrytëzohen nga ana e Shtëpisë Ndëshkuese Përmirësuese (mënyrën e shfrytëzimit, të drejtën e pronësisë kulturën e pronave si dhe do të verifikoj vërtetësinë e dokumentacionit nga kopja në origjinal).

3. Pas përfundimit të këtij procesi komisioni ka për obligim që të hartoj procesverbal lidhur me gjendjen e konstatuar të këtyre pronave dhe të njëjtin duhet t'ia adresoj kuvendit të komunës.

4. Për zbatimin e këtij vendim kujdeset komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

9.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për lejimin e ndërrimit të destinimit të pronës së paluajshme komunale në pronësi të Komunës;

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP- paraqiti sqarime hyrëse lidhur me këtë pikë të rendit duke elaboruar se për këtë pronë nevojitet vendim i kuvendit për ndërrimin e kulturës së kësaj prone pasi që në elaboratin kadastral figuron kultura "lumë" e që gjendje në teren është e ndryshme pasi atë kemi me të bëjmë me rrugë e cila duhet të funksionalizohet.

Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit-tha se nuk mund ta voton këtë pikë pasi që nuk e dinë gjendjen faktike se si është në atë pronë se a është "lumë" apo rrugë, andaj ne si anëtarë të kuvendit shpeshherë po votojmë pa e ditur se çfarë po votojmë. Pastaj apeloj që kuvendi mos të ngutet kur të votoj çështje të caktuara sidomos për pronat e komunës pa e konstatuar saktë dhe drejt gjendjen në terren për ato prona.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-sqaroi në këtë çështje ku kërkohet ndërrimi i kulturës së kësaj prone bëhet fjalë për një ish "prrock" e cila më vonë është shfrytëzuar edhe si rrugë e arave që gjendet përballë shkollës "Çajupi" dhe mesa mban mend ai asnjëherë në atë vend nuk ka pasur lumë edhe pse në dokumentacionin kadastral ekziston si "lumë". Andaj qëllim është që kësaj prone ti ndërrohet emri dhe kjo pronë të ruhet.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se kërkesa e cila është parashtruar për ndërrimin e kulturës së kësaj prone nga "lumë" në rrugë të pronës komunale, konsideron se votimi i kësaj pike nuk

paraqet ndonjë problem por për kundër kjo do ti hynte në punë atyre familjeve gjegjësisht investitorit i cili e ka dhënë propozimin dhe kuvendi komunal nuk duhet të paraqitet si pengës për asnjë investitorë dhe se obligim i kuvendit është që të përkrahen investimet. Mirëpo përkundër këtyre ai nuk është i sigurt se a është në rregull gjithçka dhe se a është dashur të merre pëlqimi nga Agjencia për Menaxhimin e Lumenjve. Në fund tha se në harta kjo pronë ekziston me kulturë "lumë" dhe në këtë rast po bëhet ndërhyrje në konfiguracionin e hartave prandaj me këtë rast duhet të shikohet ana ligjore dhe kjo çështje të procedohet dhe të votohet.

Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit-tha se nuk pajtohet që të dëmtohet asnjë biznes i komunës sonë dhe shtoi se kur marrim vendime nuk duhet që me ato vendime të favorizohet një subjekt (biznes) dhe tjetri të dëmtohet dhe në këtë prizëm qëndron poenta. Pastaj ai duke ju referua një vizite që ka pasur në fshatin Pasomë njoftoi se nga shfrytëzimi jo adekuat i një shkëmbi pluhuri shkonte lart deri në 100 metra. Andaj lidhur me këtë shtrohet pyetja se kush e kompenson atë dëm që iu shkaktohet banoreve të atij fshati dhe ceku se këto gjëra vetëm tek ne tolerohen. Mandej ai vlerësoi se tek çështje që është objekt i trajtimit duhet të dilet në teren dhe të konstatohet gjendje sepse mos dikush po dëmtohet për atë se tek ne po shihet se si është gjendja ku disa njerëz kanë bërë monopol të pasurisë dhe në saj të egoizmit të tyre po gllabërojnë pronat e të tjerëve dhe për këtë nëse nuk ke një familje të fortë atëherë askush nuk të mbron nga kanosja e tyre. Lidhur me këtë aksentoi se këta njerëz kush duhet ti mbroj? Qeveria është ajo që duhet ti mbroj, kuvendi duhet ti mbrojë dhe jo që çështja e mbrojtëse dhe sigurisë të mbetet në dorë të familjeve duke bërë vetëmbrojtje.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –tha se nuk mund të jetojmë dhe punojmë në saje të paragjyqimeve, pavarësisht faktit që investitori ka shpreh vullnetin e tij për të investuar në infrastrukturë në rregullimin e asaj rruge por edhe në ndërtimin e kanalizimit në ujësjellës dhe shtrimin e kubzave. Prandaj lidhur me këtë propozoi që komisioni të formohet dhe ta dal ta ta konstatoj gjendje në teren. Në fund ai parashtroj emrat e komisionit në fjalë.

Në fund të diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim formohet komisioni komunal për konstatimin e gjendjes faktike në parcelën kadastrale nr. P-70202016-02119-0 në sipërfaqe prej 499 m² ZK-Vushtrri pronë e komunës së Vushtrrisë në këtë përbërje:

1.1 Habib Mustafa, anëtar i kuvendit;

1.2 Shkelzen Feka anëtar i kuvendit;

1.3 Ali Januzi, anëtar i kuvendit;

1.4 Sabri Ferati, anëtar i kuvendit dhe

1.5 Bedri Dobra, (Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër, dhe Pronë).

2.Komisioni në fjalë ka për obligim që të konstatoj saktë dhe drejtë gjendjen faktike të pronës së sipër cekur duke identifikuar destinimin (kulturën) e saj.

3. Pas përfundimit të këtij procesi komisioni ka për obligim që të hartoj procesverbal lidhur me gjendjen e konstatuar të kësaj prone dhe të njëjtin duhet t'ia adresoj kuvendit të komunës.

4. Për zbatimin e këtij vendim kujdeset komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

10.Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës së paluajtshme komunale ndërtimore të Komunës së Vushtrrisë;

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se ky propozim-vendim është plotësuar me rekomandimet e bëra në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe propozoi që te pika tre e këtij propozim-vendim ku thuhet jepen në shfrytëzim 460 m² neto në kllapa duhet të saktësohet ,(nga 115 m² neto për katër familjet të cilat banojnë në objektin në fjalë), dhe kjo do ta ndihmonte komisionin që mos të bie në lajthitje gjatë punës së tij.

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit-tha se lidhur me propozim-Vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të pronës të paluajtshme komunale ndërtimore të Komunës së Vushtrrisë, pyeti se ato dy ndërtesa të cilat janë ndërtuar në të njëjtin vit dhe në dokumentacion thuhet se ato paraqesin rrezik për banoret që jetojnë aty dhe nëse njëra parqet rrezik atëherë edhe ndërtesa tjetër paraqet rrezik, pastaj nuk kemi kërkesë që kanë kërkuar që kjo pronë të jepet në shfrytëzim për 99 vite kurse banesa tjetër që është afër a është pronë e komunës apo është nënë administrimin e AKP-së.

Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-tha se në këtë lokacion ndodhen dy banesa me sipërfaqe të caktuar dhe të njëjtat janë pronë komunale ai njoftoi se një formë e tillë e dhënies së pronës në shfrytëzim ka filluar tani dhe është mirë që ky projekt të shtyhet përpara.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se dhënia e pronës në shfrytëzim është një çështje delikate dhe shtoi se kjo formë e dhënies në shfrytëzim do të provohet dhe do shohim se çfarë rezultatesh do të arrihen. Tutej shtoi se investimi në këtë pronë (objekt) do të bëhet në pajtueshmëri me banoret të cilët banojnë në atë ndërtesë dhe përfitimet e tyre do të jenë në proporcion me sipërfaqen e pronës që e posedojnë aktualisht. Lidhur me këtë çështje ceku se me procedurat e ankandit do të merret komisioni komunal i mandatuar për këtë çështje si dhe Drejtoria e Prokurimit.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit-kërkoi që të sqarohet çështja e cila ka të bëjë që banoret do të përfitojnë 460 m² duke ju shpërndarë atyre por në rastin konkret pyeti se cili do të jetë interesi i komunës

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se është fat i mirë që e kemi komisionin për dhënien e pronës në shfrytëzim dhe pasi të zhvillohen procedurat e ankandit atëherë ofertat më të mira që do të përfitohen do sillen sërish në kuvend që të analizohen që mirëfilli të shihet interesi i komunës se çfarë po përfiton komuna.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 23 vota “për”, tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite e pronës së paluajtshme të komunës së Vushtrrisë në ngastrat kadastrale nr. 2256-11-e cila është pronë e komunës, Zona Kadastrale Vushtrri, me kulture oborr 500 m²,kullosë 110m² dhe ndërtesë 200m² gjegjësisht gjithsejtë: 810m² ku nga sipërfaqja e përgjithshme jepen në shfrytëzim 675 m², e cila gjendet në rrugën “Jeton Tërrstena” Vushtrri.

2.Prona e cekura në pikën 1 të këtij vendimi jepet në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite përmes ankandit personave fizik dhe juridik, për rregullimin dhe ndërtimin e objektit banesor-afarist të cilat janë të parapara sipas Planeve Rregulluese Urbane në fuqi.

3.Komuna do ta ruaj interesin e saj publik përmes kushteve që do ti përcaktoj me rastin e zhvillimit të procedurave të ankandit publik, kurse pjesën tjetër investitori. Çmimi fillestar i ankandit publik të jetë 460m² banim neto,(nga 115 m² neto për katër familjet të cilat banojnë në objektin në fjalë) ndërsa investitori ta merr përsipër pagesën e qirasë mujore në vlerë prej 150€ për katër familje, deri në dorëzimin e çelësave.

4.Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale të zhvilloj procedurat për shpalljen e ankandit si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të

Mjedisit që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit .

5.Pjesë e këtij Vendimi janë: certifikatat e pronësisë kopja e planit incizimi gjeodezik, skica e Planit Zhvillimor Komunal të Vushtrrisë e paraqitur në pjesë grafike dhe pjesa tekstuale.

11.Të ndryshme.

a).Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë;

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –ceku se rekomandimi i Komitetit për Politikë dhe Financa në pikën 8 të propozim-vendimit është plotësuar me tekstin si në vijim: Hartën Zonale të Komunës e harton APKPMH (Autoriteti Komunal Përgjegjës për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor) së bashku me drejtoritë sektoriale dhe burimeve njerëzore brenda komunës sipas Ligjit Nr. 03/L-241 Për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-tha se qëllimi i aprovimit të këtij propozim-vendimi është mundësia e përfitimit të ndonjë donacioni por në fund të këtij vendimi ekziston pasuese se ky vendim do të zbatohet vetëm atëherë kur të aprovohet Plani Zhvillimor Komunal.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 24 vota “për”, të ” tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim fillohet hartimi i hartës zonale të komunës (HZK).

2.Me këtë vendim përkufizohet: hartimi i Hartës Zonale të Komunës është një dokument multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor . Harta Zonale e Komunës duhet të përfshijë planin dhe zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për periudhën kohore së paku tetë (8) vite.

3.Me hartimin e Hartës Zonale të Komunës nga pika 1 i këtij vendimi arrihet shtrirja hapësinore dhe gjeografike e qëllimeve dhe objektivave të parapara me Planin Zhvillimor Komunal , me qëllim të përcaktimit të hollësishëm të llojit , destinimit dhe shfrytëzimit të planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të bazuara në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë.

4.Territori i Komunës së Vushtrrisë ka sipërfaqe prej $S=345 \text{ km}^2$ dhe ndahet në 67 zona kadastrale të cilat janë:

4.1 Akrashticë, Balincë, Banjskë, Beçiq, Beçuk, Begaj, Bivolak, Bozhlan, Brusnik, Bukosh, Ceceli, Dalak, Dobëllukë, Druar, Dubovc, Dumnicë e Epërme, Dumnicë e Llugës, Dumnicë e Poshtme, Galicë, Gllavatinë, Gojbulë, Gracë, Gumnishtë, Hercegovë, Karaçë, Kollë, Kunovikë, Kurillovë, Jezerë, Lumadh, Mavriq, Maxhunaj, Mihaliq, Miraçë, Nedakoc, Novolan, Ashlan, Pantinë, Pasomë, Pestovë, Prelluzhë, Reznik, Ropicë, Samadrexhë, Sfaraçak i Epërm ,Sfaraçak i Poshtëm, Shalë, Shilovicë, Skoçan, Skromë, Sllakoc, Sllatinë, Smrekonicë, Stanoc i Epërm, Stanoc i Poshtëm, Stroc, Studime e Epërme, Studime Poshtme, Taraxhë, Tërllabuq, Vërrnicë, Vesekovc, Vilanc, Vushtrri, Zagorë dhe Zhilivodë.

5. Bartës i punimit të Hartës Zonale të Komunës caktohet: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

6. Monitorimi i zbatimit të Hartës Zonale të Komunës bëhet nga Kuvendi i Komunës, hartimi dhe raportimi i raportit vjetor lidhur me zbatimin e tij.

7. Mjetet për punimin e dokumentit të planifikimit hapësinor sigurohen nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë.

8. Hartën Zonale të Komunës e harton APKPMH (Autoriteti Komunal Përgjegjës për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor) së bashku me drejtoritë sektoriale dhe burimeve njerëzore brenda komunës sipas Ligjit Nr. 03/L-241 Për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës.

9. Harta Zonale e Komunës do të jetë bazë për punimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme (PRRH).

10. Harta Zonale e Komunës do të jetë e bazuar në Planin Zhvillimor Komunal (PZHK), pas miratimit të tij në Kuvendin e Komunës.

11. Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi është i obliguar që dokumentin e planifikimit hapësinor ta hartojë në afat prej 10 muaj nga dita e përzgjedhjes së përfituesit për Hartimin e Hartës Zonale.

12. Hartimi i Hartës Zonale të Komunës , para finalizimit duhet të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e HZK në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

13. Dokumenti i Hartës Zonale të Komunës (HZK) hartohet për periudhën kohore tetë (8) vite.

14. Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jetë në gjuhët zyrtare të komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

15. Vendimi mbi punimin e dokumentit të planifikimit hapësinor (HZK) është dokument publik dhe shpallet në Gazetën Zyrtare.

16. Pjesë e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit i paraparë me nenin 11 pika 1.3 të Ligjit për Planifikim Hapësinorë Nr. 04/L-174.

17. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe drejtorit tjera kompetente komunale.

b). Shqyrtimi i kërkesës së auto- kombajnerëve të Komunës së Vushtrrisë;

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –tha se ka biseduar me përfaqësuesit e shoqatës së auto- kombajnerëve të Komunës së Vushtrrisë, dhe kërkesë e tyre është që të merret një qëndrim nga ana e kuvendit që t’iu ndalohej auto- kombajnerëve nga komunat tjera qarkullimi

në territorin e Komunës së Vushtrrisë sepse të njëjtëve po iu ndalohej në komunat tjera andaj kërkoi nga kuvendi që një kërkesë e tillë të përkrahet.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-njoftoi se kishte pasur një takim të rastësishëm me përfaqësuesit e kësaj shoqate dhe se ata e kishin njoftuar se në dy komuna të Kosovës iu janë ndaluar qarkullimi auto- kombajnerëve nga komuna jonë, dhe tani ata kërkojnë nga kuvendi që të veprojnë njëjtë sikurse komunat tjera. Në fund ai tha nuk e di se sa ka të drejt ligjore kuvendi të merr një vendim për ndalimin e qarkullimit të këtyre auto- kombajnerëve por nëse e merret një vendim i tillë ai është i obliguar të zbatoj atë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-tha se komuna ka rreth 80 kombajna në gjendje të rregullt, dhe shtoi se tregu për të operuar është i lirë dhe kuvendi nuk mund ti ndaloj auto- kombajnerëve nga komunat tjera, por Drejtoria për Bujqësi dhe Drejtoria për Inspektime mund ti obligoj këta auto- kombajnerë që të marrin pëlqim nga ana këtyre drejtorive për të operuar në komunën tonë andaj Drejtori e Bujqësisë mund të përshkruaj kriteret për këta auto- kombajnerë dhe në këtë formë ti mbrojtë interesat e shoqatës në fjalë.

Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit-tha se duhet ti jepen përparësi auto-kombajnerëve të komunës sonë. Pastaj ai shprehu brengen e tij se shumë operator ekonomik po marrin punë në komunën tonë dhe kështu po anashkalohen firmat tona.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit –tha se parimisht pajtohet se duhet të mbrohen auto kombajnerët e komunës sonë por një çështje duhet të kihet parasysh që mos të vijmë në kundërshtim me ligjin. Lidhur me këtë temë ai propozoi që drejtoria gjegjëse duhet ti drejtohet me kërkesë nivelit qendror që të merret një qëndrim unik për të gjithë se si të veprohet në këtë çështje.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –tha se kuvendin i komunës nuk është i interesuar që ti pengoj bizneset po përkundrazi ne do të bëjmë përpjekje që ti ndihmojmë bizneset të cilat operojnë në komunën tonë. Andaj në këtë rast kërkoj që kuvendi të aprovoj në vendim me të cilin do të obligohej Drejtoria e Bujqësisë dhe Drejtoria e Inspektimeve që auto-kombajnerëve nga komunat tjera të Kosovës të marrin pëlqim nga drejtorit e sipër cekura lidhur me kushte teknike për të operuar në komunën tonë konform ligjeve në fuqi.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 23 vota “për”, të ” tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim obligohen të gjithë auto-kombajnerët që operojnë jashtë territorit të Komunës së Vushtrrisë që të marrin pëlqim për ushtrimin e veprimtarisë së tyre në territorin e Komunës së Vushtrrisë nga Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe nga Drejtoria për Inspektime.

2.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Inspektime.

c). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit-tha ka pasur diskutimi për ndërtimin e rrugës në fshatin Pasomë por informatë zyrtare nuk kemi se ky projekt do të finalizohet. Tutje shtoi se nuk është mirë që të mbetet deri në fund që kjo rrugë të rregullohet kur do shfrytëzohet ai shkëmb (guri) por që kompania që po ekspluton atje ka mundësi që këtë rrugë në fund nuk do ta rregulloj fare. Pastaj ceku se operatori i cili ishte më herët duke shfrytëzuar atë “guri” e ka dëmtuar tej mase rrugën dhe shtëpitë përreth dhe asnjëherë askush nuk marrë përgjegjësi për këto dëme. Në fund tha se ai gurthyes duhet ta rregulloj rrugën në fshatin Pasomë para se ta përfund procesin e shfrytëzimit të gurit në atë fshatë për faktin se ka mundësi që në fund rruga të mos ndërtohet.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit-ju sugjeroi autoriteteve komunale që të pastrohet lumi i “Studimës” nga rruga maxhistrale deri tek zjarrfikësit pasi lumi në këtë gjendje paraqet rrezik sidomos për fëmijët. Pastaj duhet të pastrohet lumi “Tërrstena” për faktin se shtëpitë përreth këtij lumi “natën nuk mund të bëjnë gjumë” për shkak të bretkosave dhe mushkonjave. Tutej autoritetet e inspektimit atje ku ka ndezje të zjarreve ti parandaloj këto zjarre me qëllim që të mos ndotet ambienti. Në fund tha se duhet të punohet në zbatimin e rregulloreve komunale sa i përket orarit të punës sidomos të lokaleve të natës që organizojnë dasma dhe ahengje të cilat lokale po e prishin qetësin publike, mandej të kursehet uji i pijshëm si dhe të punohet në çështjen e dezisektimit për faktin se këtë verë është shfaqur së tepërmi kjo nevojë dhe me këtë do të parandaloheshin ndonjë epidemi eventuale.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit-paraqiti shqetësimin e tij lidhur me një gropë e cila ndodhet tek shkolla e fshatit Stroc e cila paraqet rrezik permanent për nxënësit e shkollës dhe për kalimtarët tjerë. Lidhur me këtë problem ai kërkoi nga autoritetet komunale që të veprohet shpejt në gjetjen e një zgjidhje. Në fund tha se kjo problematik do të mund të zgjidhje duke vendosur një mbrojtëse (gardhë), apo duke u mbushur ajo vrimë (gropë) me materiale ndërtime.

Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit-tha se rruga nga fshati Sllatinë në drejtim të fshatit Pasomë veç është shkatërruar dhe banoret e fshatit Pasomë janë të dëmtuar në shumë aspekte nga zhurma, pluhuri dhe disa shtëpi janë dëmtuar në masë të madhe. Andaj lidhur me këtë çështje kërkoi që komuna të ndërmarr masa të shpejta për që ky operator ekonomik të kushtëzohet që ta bëjë ndërtimin e kësaj rruge për ndryshe ai vetëm do ta shfrytëzoj atë shkëmb (guri) dhe të gjitha obligimet për këtë rrugë do ti ja lërë komunës. Në fund ai paraqiti kërkesën për ndihmë ndaj një qytetari Zekë Hajrizi nga fshati Stroc i cili gjendet në gjendje të rëndë shëndetësore ekonomiko-sociale por edhe të banimit i cili banon në një shtëpi të vëllait të tij dhe duhet që urgjentisht ti bëhet një zgjidhje e banimit.

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit-parashtroj një pyetje në emër të qytetarëve të lagjes “podrança” ku atje është duke u ndërtuar një rrugë në lagjen “Kastrati” dhe pyetja e tyre është se përse ndërtimi i kësaj rruge nuk po vazhdon më tutje në aneksi deri në fshatin Dobërrlukë dhe kërkesa e tyre është që në kuadër të rishikimit të buxhetit të bëhet ndërtimi i këtij aneksi të kësaj rruge.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit –adresi pyetje për Drejtoreshe e Drejtorisë së Bujqësisë lidhur me deklarin e pasurisë që ka bërë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, pasi që ajo merr pagë nga Komisioni Evropian por njëkohësisht ajo merr pagë edhe nga buxheti i komunës dhe me këtë rast ajo duhet të përgjigjet se a gjendet në konflikt të interesit pasi që parat të cilat i merr nga Komisioni Evropian derdhen në buxhetin e komunës, njëkohësisht ajo duhet të deklarohet se a ka bërë deklarin të rrejshëm të pasurisë. Në fund ai në emër të tij por edhe të të gjithë anëtarëve të kuvendit të gjithë besimtarëve të fesë Islame iu uroi Festen e Fitër Bajramit.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës-duke paraqitur sqarime para anëtarëve të kuvendit theksoi se kompania e cila është marrë më herët me shfrytëzimin e gurit (shkëmbit) në fshatin Pasomë e kishte shitur të drejtën e shfrytëzimit një tjetër kompanie dhe njoftoi se ka biseduar me dy kompanitë dhe për këtë nuk mund të flasim se sa kishte të drejt kjo kompani që ka shitur të drejtën. Tutje shtoi se kompania e cila e ka marrë tash janë të interesuar që të bëjnë ndërtimin e rrugës nga atu ku ishte mbetur e deri tek gurëthyesi dhe kjo të bëhet në bashkëfinancim me komunën. Lidhur me këtë dy komisione komunale janë dal në terren për ta vlerësuar gjatësinë e rrugës por që të vlerësohet edhe gjendja e rrugës e cila është shtruar më herët dhe e cila është dëmtuar. Pastaj lidhur me dëmtimin e rrugës dhe obligimin e kompanisë për ta riparuar këtë rrugë kompania kontraktuese e më hershme është justifikuar që kur e kishte shitur të drejtën e kishte shitur së bashku me obligimin që këtë rrugë ta riparoj, kurse kompani që e ka blerë këtë të drejt e mohon një obligim të tillë. Ndërsa lidhur me ofertën e kompanisë së re për ndërtimin e asaj rruge me bashkëfinancim do të kërkojmë që kompania të shtroj këtë rrugë mbi masën e

50 % kurse ne do ta shikojmë anën ligjore që pjesa tjetër e rrugës të ndërtohet në saje të procedurave të prokurimit. Mandej duke referuar lidhur me këtë çështje ceku se për gurthyesin në fshatin Tarllabuq nuk është i njoftuar por kompanitë ndërtuese të rrugëve duhet që në një formë të furnizohen me zhavorr por gjithherë shfrytëzimi duhet të bëhet në baza ligjore. Tutej pastrimi i lumit të “Studimës” duhet të bëhet me projekt kurse për pastrimin e lumit “Tërrstena” projekti është në procedurë të zhvillimit që shtrati i lumit të shtrohet në çimento, kurse lidhur me keqpërdorimin e ujit është ndërmarrja kompetente e cila merret me këtë çështje por me zyrtaret e kësaj kompanie e ka ngritur disa herë këtë çështje. Pastaj lidhur me gropën në fshatin Stroc njoftoi se e ka kërkuar me shkrim nga Drejtoria e Emergjencës dhe Drejtoria e Inspektiveve që të ngritin nivelin e përkujdesjes dhe të marrin masa ofrimin e sigurisë për të gjithë qytetarët. Lidhur me ofrimin e ndihmës për Zekë Hajrizin e ka shikuar mundësin por në mungesë të mjeteve financiare nuk është bërë e mundur ofrimi i zgjidhjes për të. Ndërsa për ndërtimin në aneksin deri në fshatin Dobërlukëv për këtë vit do shtrohet aq sa ka mjete kurse pjesa tjetër do shikohet mundësia për vitin tjetër. Në fund lidhur me dezisektimin do ti propozoi Drejtorisë së Shëndetësisë se çfarë ka mundësi të bëjë me këtë proces, kurse lidhur me të ardhurat shtesë të Drejtoreshës së Bujqësisë njoftoi se ajo i merr të ardhurat në bazë të planifikimit të projektit kurse a kemi konflikt të interesit në këtë rast këtë e vërteton Agjencioni Kundër Korrupsionit por edhe gjykata kompetente.


Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit—tha se çështja e rrugës së dëmtuar në fshatin Pasomë është histori në veti dhe për këtë më së shumti pasoja ka pasur banoret e atij fshati, kurse lidhur me gurthyesin në atë fshatë ceku se nëse organet komunale i kanë dhënë pëlqim për shfrytëzimin e atij guri atëherë është mundësia që ai pëlqim të tërhiqet, ndërsa lidhur me bashkëfinancimin e projektit për atë rrugë duhet që komuna të përcaktoj dhe diktoj kushtet e veta nëse ka interes në këtë projekt.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Shpëtim Zhegrova


Kryesues i Kuvendit

